

DIREKTIVA NR. 76/207/KEE, “MBI ZBATIMIN E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË PËR BURRAT DHE GRATË NË LIDHJE ME PUNËSIMIN, FORMIMIN PROFESIONAL DHE NGRITJEN NË DETYRË, DHE KUSHTEVE TË PUNËS”

9 shkurt 1976

Këshilli i Komuniteteve Evropiane,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian, në veçanti nenin 235 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social,

Ndërkohë që Këshilli, në rezolutën e tij të datës njëzet e një janar njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër, në lidhje me programin social të veprimit, përfshirë ndërmjet veprimeve prioriteteve me qëllim arritjen e barazisë ndërmjet burrave dhe grave përsa i përket punësimit, formimit profesional, ngritjes në detyrë dhe kushteve të punës, përfshirë dhe pagën.

Ndërkohë që, përsa i përket pagës, Këshilli miratoi, në dhjetë shkurt njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë, Direktivën nr. 75/117/KEE “Mbi përfrimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me zbatimin e parimit të pagës të barabartë për burrat dhe gratë;

Ndërkohë që veprimi Komunitar, gjithashtu, duket të jetë i nevojshëm për arritjen e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me punësimin, formimin profesional, ngritjen në detyrë dhe përsa i përket kushteve të tjera të punës;

Ndërkohë që, trajtimi i barabartë për punëtorët, burra dhe gra, përbën një nga objektivat e Komunitetit, për aq sa harmonizimi i kushteve të punës dhe jetesës, ndërsa ruhen përmirësimet e tyre, ka ecur më tej;

Ndërkohë që, Traktati nuk ofron kompetencat e nevojshme të kërkuara për këtë qëllim;

Ndërkohë që përcaktimi dhe zbatimi progresiv i parimit të trajtimit të barabartë në çështjet e sigurimit shoqëror, duhet të realizohet me anë të instrumenteve të mëposhtëm,

Ka miratuar këtë Direktivë:

Neni 1

1. Qëllimi i kësaj Direktive është të bëjë efektive në shtetet anëtare, parimin e trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë përsa i përket punësimit, përfshirë ngritjen në detyrë, formimit profesional si dhe të kushteve të punës dhe , mbi kriteret e referuara në paragrafin 2, të sigurimit shoqëror. Ky parim, që tani e tutje, do të referohet si “parimi i trajtimit të barabartë”.

2. Me qëllim që të sigurohet zbatimi progresiv i parimit të trajtimit të barabartë në çështjet e sigurimit shoqëror, Këshilli, me propozim të Komisionit, do të miratojë dispozita që përkufizojnë thelbin dhe qëllimin e tij si dhe masat për zbatimin e këtij parimi.

Neni 2

1. Për qëllimet e dispozitave të mëposhtme, parimi i trajtimit të barabartë do të thotë që nuk do të ketë asnjë lloj diskriminimi, të drejtpërdrejtë ose jo, për shkak të gjinisë, duke iu referuar në mënyrë të veçantë gjendjes civile ose familjare.

2. Kjo Direktivë nuk cenon të drejtën e shteteve anëtare që të përjashtojnë nga fusha e zbatimit të kësaj direktive ato aktivitete profesionale dhe, kur është e mundur, edhe trajnimin për këto aktivitete profesionale, për të cilat, për shkak të vetë natyrës së tyre ose të kontekstit në të cilin realizohen, gjinia e punëtorit përbën një faktor vendimtar.

3. Kjo Direktivë nuk do të cenojë dispozitat në lidhje me mbrojtjen e grave, veçanërisht përsa i përket periudhës së shtatzënisë dhe amësisë.

4. Kjo Direktivë nuk do të cenojë masat për te nxitur mundësitë e barabarta për burrat dhe gratë, veçanërisht duke eliminuar pabarazitë ekzistuese të cilat prekin mundësitë e grave në fushat e referuara në nenin 1 (1).

Neni 3

1. Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë nënkupton se nuk duhet të ketë asnjë diskriminim mbi bazë gjinie në kushtet, përfshirë kriteret e përzgjedhjes, e hyrjes në punë apo emërimit në një detyrë, pavarësisht nga sektori apo linja e aktivitetit, dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale.

2. Në këtë aspekt, shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar:

a. shfuqizimin e çdo ligji, rregulloreje dhe dispozite administrative që është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë,

b. çdo dispozitë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, të cilat janë përfshirë në marrëveshjet kolektive, në kontratat individuale të punës, në rregullat e brendshme të sipërmarrjeve, ose në normat që rregullojnë profesionet e lira, duhet të/ose deklarohen të pavlefshme ose të rregullohen;

c. duhet të rishikohen ato ligje, rregullore dhe dispozita administrative të cilat janë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe që nevoja për mbrojtjen e këtij parimi, që bëri të mundur miratimin e tyre, nuk është më e bazuar; dhe në rastin kur dispozita të së njëjtës natyrë janë përfshirë në marrëveshjet kolektive të punës, punëdhënësve dhe punëmarrësve do tu kërkohet të ndërmarrin ndryshimet e nevojshme.

Neni 4

Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në lidhje me aksesin në të gjitha llojet dhe nivelet e punësimit, drejtimit profesional, formimit profesional, formimit të avancuar profesional dhe ri-trajnimit, nënkupton që shtetet anëtare do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar:

a. shfuqizimin e çdo ligji, rregulloreje dhe dispozite administrative që është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë,

b. çdo dispozitë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, të cilat janë përfshirë në marrëveshjet kolektive, në kontratat individuale të punës, në rregullat e brendshme të sipërmarrjeve, ose në normat që rregullojnë profesionet e lira, duhet të/ose deklarohen të pavlefshme ose të rregullohen;

c. pa cenuar lirinë e garantuar nga disa shtete anëtare për disa sipërmarrje trajnuese private, drejtimi profesional, formimi profesional, formimi i avancuar profesional dhe ri-trajnimi, do të jetë i mundshëm mbi bazën e kriterëve dhe niveleve të njëjta, pa asnjë lloj diskriminimi bazuar në gjini.

Neni 5

1. Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në lidhje me kushtet e punës, përfshirë normat që rregullojnë pushimin nga puna, nënkupton që burrave dhe grave duhet tu garantohen kushte të njëjta, pa asnjë lloj diskriminimi bazuar në gjini.

2. Në këtë aspekt, shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar:

a. shfuqizimin e çdo ligji, rregulloreje dhe dispozite administrative që është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë,

b. çdo dispozitë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, të cilat janë përfshirë në marrëveshjet kolektive, në kontratat individuale të punës, në rregullat e brendshme të sipërmarrjeve, ose në normat që rregullojnë profesionet e lira, duhet të/ose deklarohen të pavlefshme ose të rregullohen;

c. duhet të rishikohen ato ligje, rregullore dhe dispozita administrative të cilat janë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe që nevoja për mbrojtjen e këtij parimi, që bëri të mundur miratimin e tyre, nuk është më e bazuar; dhe në rastin kur dispozita të së njëjtës natyrë janë përfshirë në marrëveshjet kolektive të punës, punëdhënësve dhe punëmarrësve do tu kërkohet të ndërmarrin ndryshimet e nevojshme.

Neni 6

Shtetet anëtare do të përfshijnë në sistemet e tyre ligjore kombëtare të gjitha masat e nevojshme për tu mundësuar të gjithë personave, që e konsiderojnë veten padrejtësisht të përjashtuar nga zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë, brenda kuptimit të neneve 3, 4 dhe 5, që të kërkojnë pretendimet e tyre edhe nëpërmjet procesit gjyqësor, mundësisht pas ankimit pranë autoriteteve të tjera kompetente.

Neni 7

Shtetet anëtare do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur punëmarrësit nga pushimi nga puna prej punëdhënësve, si reagim ndaj ndonjë ankese brenda kësaj sipërmarrjeje ose ndaj ndonjë procesi ligjor, që synon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 8

Shtetet anëtare do të kujdesen që dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj Direktive, së bashku me dispozitat përkatëse që janë tashmë në fuqi, do tu bëhen të ditur punëmarrësve me anë të gjithave mënyrave të përshtatshme, si për shembull në vendet e tyre të punës.

Neni 9

1. Shtetet anëtare do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita të nevojshme administrative, me qëllim përputhshmërinë me këtë Direktivë, brenda tridhjetë muajve nga njoftimi i saj. Shtetet anëtare duhet të informojnë menjëherë Komisionin për këto masa.

Megjithatë, në lidhje me pjesën e parë të nenit 3(2)(c) dhe pjesën e parë të nenit 5(2)(c), shtetet anëtare do të ndërmarrin një kontroll dhe, nëse është e nevojshme, një rishikim të ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të referuara këtu, brenda katër viteve nga njoftimi mbi këtë Direktivë.

2. Shtetet anëtare do të vlerësojnë, në mënyrë periodike, aktivitetet e punësimit referuar nenit 2(2), në mënyrë që të vendosin, duke pasur parasysh zhvillimet sociale, nëse ekzistojnë justifikime për ruajtjen e përjashtimeve lidhur me to. Ato do të njoftojnë Komisionin për rezultatet e këtij vlerësimi.

3. Shtetet anëtare do të dërgojnë, gjithashtu, pranë Komisionit tekstet e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, të cilat ato do të miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.

Neni 10

Brenda dy viteve pas përfundimit të periudhës tridhjetë mujore, të përcaktuar në nën paragrafin e parë të nenit 9(1), shtetet anëtare do t'i dërgojnë Komisionit çdo informacion të nevojshëm për të bërë të mundur hartimin e një raporti mbi zbatimin e kësaj Direktive, raport i cili do t'i paraqitet Këshillit.

Neni 11

Kjo Direktivë i adresohet shteteve anëtare.